REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 364/1 prot.

Pogradec, më 11, 02, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETARE E
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

E nderuar znj. Kryetare !

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

"PËR MIRATIMIN E PROÇESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANESËS NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC, NË FAVOR TË FAMILJES SË Z.MUHAMET FERIT GOLEMI, E CILA KA MBETUR PA PRIVATIZUAR"

Me respekt:
KRYETARI
Ilir XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
K Ë SH I LL I

Nr. _____Prot.

Pogradec, më ____.___.2026

PROJEKT VENDIM

"PËR MIRATIMIN E PROÇESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANESËS NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC, NË FAVOR TË FAMILJES SË Z.MUHAMET FERIT GOLEMI, E CILA KA MBETUR PA PRIVATIZUAR"

Në mbështetje dhe zbatim të: Ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", Ligjit nr. 7652/1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" , Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" , VKM Nr.179/2020 "Për rregullat dhe procedurat e privatizimit të banesave shtetërore", VKM Nr.97 "Per menyren e privatizimit..." Ligjit 111/2018 "Per kadastren". VKM nr. 898/2020 si dhe akteve nënligjore në fuqi ;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin e projekt vendimit te privatizimit të banesës shtetërore në favor të familjes së z.Muhamet Ferit Golemi te dt.01.12.1992, sipas kerkeses së paraqitur/drejtuar bashkisë Pogradec, vërtetimit të mandat pageses, vërtetimeve si dhe te gjitha dokumentacioneve te tjera ligjore dhe proçeduriale, bashkëlidhur relacioni.
2. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për të lidhur Kontratën e Privatizimit para Noterit për vazhdimin e regjistrimit të banesës për pajisje me Çertifikatë Pronësie në ASHK-Hipotekë ku përfitues do të jetë familja e datës.01.12.1992 sipas ligjit.7652 "Për privatizimin e banesave...".
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes nëse gjatë këtij afati nuk ka ankesa.

K R Y E T A R E
Manjola KAMOLLI

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222227, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3647/1 prot.

Pogradec, më 21.04.2026

Lënda:

RELACION

"PËR MIRATIMIN E PROÇESIT TË PRIVATIZIMIT TË BANESËS NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC, NË FAVOR TË FAMILJES SË Z.MUHAMET FERIT GOLEMI, E CILA KA MBETUR PA PRIVATIZUAR"

I. BAZA LIGJORE

Ky relacion, hartohet në mbështetje të bazës ligjore dhe faktike si më poshtë:

- **Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** (Garantimi dhe rregullimi i të drejtës së pronës private);
- **Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë** (Rregullat mbi kalimin e pronësisë dhe detyrimet kontraktore);
- **Ligji Nr. 7652, datë 23.12.1992** "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar;
- **Ligjit nr.9321 dt.25.11.2004** "për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore"
- **Ligji Nr. 22/2018** "Për strehimin social", i ndryshuar;
- **Ligji Nr. 20/2020** "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë";
- **Ligji Nr. 139/2015** "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- **VKM Nr.179, datë 26.02.2020** "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit të privatizimeve" e ndryshuar me **VKM Nr.320 datë.06.05.2026.**
- **Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë** (bashkëlidhur) për kalimin e banesave nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) në pronësi të Bashkisë Pogradec.
- **VKB Nr.12 dhe Autorizimit Nr.12 Dt.01.03.1999** per strehimin e familjes.
- Legjislacionit në fuqi për administrimin e pasurive publike dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

II. PËRSHKRIMI I SITUATËS FAKTIKE DHE LIGJORE:

Pranë Sektorit të Strehimit të Bashkisë Pogradec,është paraqitur kërkesa e z.Muhamet Ferit Golemi me nr.1773.prot dt.20.04.2026, familje e cila është strehuar në **vitin 1994** dhe posedon Autorizimin origjinal nr.12 datë:01.03.**1999**. Objekti është kompleks i ndërtuar nga shteti në vitin **1988** (sipas shkreses se Urbanistikës bashkëngjitur relacionit). Bashkia Pogradec disponon Çertifikatën e Pronësisë për këtë pasuri në emër të saj. Familja nuk e ka kryer procesin e privatizimit në kohë pasi ***NUK KA PAGUAR TARIFËN E PRIVATIZIMIT TË BANESËS*** ku aktualisht banon dhe sot kërkon pajisjen me certifikatë pronësie sipas Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", Ligjit 7652 dt.23.12.1992 "Per Privatizimin e banesave shteterore" dhe VKM nr.179, datë

26.02.2020 "Per rregullat dhe kushtet e privatizimit..." ndryshuar me VKM-në nr.328/2020, për arsye se ka pasur pamundësi socio-ekonomike.

Përfituesi ka gëzuar në mënyrë të vazhdueshme banesën mbi bazën e **autorizimit** të strehimit dhe nga verifikimi i baneses ne vend nga specialistet e sekotrit te strehimit te bashkise me **akt-konstatim** ku vertetohet se aktualisht banon te ky apartament , me **kontrate energjie dhe uji** dhe vertetime te tjera si dhe plotëson kushtet ligjore për përfundimin e procedurës së privatizimit, nga ku ,qëllimi i këtij vendimi është:

- Përmbyllja e procedurës administrative të privatizimit;
- Pagesa e tarifës së mbetur për privatizim.
- Kalimi i pronësisë tek familja përfituese gjendja familjare e **dt.01.12.1992** sipas ligjit te privatizimit nr.7652 date.23.12.1992 "Per privatizimin e banesave shteterore";
- Regjistrimi i së drejtës së pronësisë në ASHK, ***mbas nënshkrimit të kontratës te Noteri.***

III. TË DHËNAT E PASURISË:

- Vendndodhja: Lagjja 4 (Kala), Pogradec (kategoria II).
- Zona Kadastrale: 8582
- Numri i Pasurisë: 9/95+1-7
- Kati: Përdhe (Truall i perbashket me pjesmarrje 23.8)
- Sipërfaqja totale e Truallit 476m2
- Sipërfaqja neto e apartamentit: 71m^2
- Tipologjia: 2+1 me kuzhinë më vete sipas Autorizimit 12 te vitit 1999.
- Përbërja familjare: 3 anëtarë sipas Çertifikates familjare te dt.01.12.1992 dhe 4 anëtarë sipas vitit 1999 te autorizimit.

IV. STATUSI JURIDIK DHE TEKNIK I PRONËS

Pas verifikimit të plotë të dosjes fizike dhe verifikimit ne vend, Sektori i Strehimit, konfirmon rregullsinë e plotë të të dhënave të mëposhtme (**bashkangjitur me Formularet perkatës**):

1. Pronësia dhe Proçedura Kadastrale: Banesa është e pajisur me certifikatë pronësie në emër të Bashkisë Pogradec, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK). Kjo vjen pas kalimit të rregullt të pronësisë nga ish-EKB në pronësi të Bashkisë Pogradec, proces i kryer rregullisht me likuidimin e të gjitha tarifave kadastrale përkatëse.

2. Përshkrimi i Pronës: Apartament i tipologjisë 2+1 me kuzhinë më vete, me sipërfaqe 71m². Banesa identifikohet me Nr.Pasurie 9/95+1-7, ZK.8582, 71m2 ndërtesë, truall 0 me kuotë pjesmarrje 23.8m^2, e ndodhur në Lagjen 4, Rr. "Kala", Pogradec (kategoria II).

3. Karakteristikat e Ndërtimit: Sipas informacionit zyrtar të përcjellë nga Drejtoria e Urbanistikës, pallati është ndërtuar në vitin 1988, është një objekt-Pallat banimi (kompleks) me 2 hyrje dhe me 20 apartamente gjithsej të dyja hyrjet (konkretisht 12 dhe 8). Apartamenti ndodhet në katin përdhe (kati 0).

4. Trajtimi Social dhe Normat e Strehimit: Subjekti disponon Autorizimin për Strehim të vitit 1999, dalë me Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB) të vitit 1999. Gjendja familjare sipas

certifikatës së vitit 1992 përbëhej nga 3 anëtarë, ndërsa në momentin e autorizimit (1999) përbëhej nga 4 anëtarë. Sipas përcaktimeve të VKM Nr.179, struktura 2+1 (71 m²) është brenda normave të strehimit për këtë strukturë familjare.

5. Dokumentacioni Tekniko-Administrativ: Janë plotësuar sipas ligjit **Formulari 1** (Kërkesa), **Formulari 2** (Vlerësimi Tekniko-Financiar) dhe **Formulari 3** drafti i Kontratës së Privatizimit **(e cila do të kryhet para Noterit), Fatura e mandat pageses (nga Dr.Taksave Vendore),** Formularet perkatës të privatizimit sipas VKM.320.

V. METODOLOGJIA DHE PËRLLOGARITJA FINANCIARE

Llogaritjet e tarifës së privatizimit janë kryer duke respektuar saktësisht metodologjinë e VKM Nr.179/2020 dhe VKM 320/2026, faktorët e vjetërsisë e indeksimit, faktore indeksimi sipas formuareve 1,2,3 is dhe faktore te tjere zbritjeje (kati 0, pagesa me 1 kest-20%) etj... konkretisht :

1.Çmimi Bazë (Tb):

Tarifa baze (Tabela 1) + (Tarifa baze x Koeficenti Tabela 2) + (Tarifa baze x Koeficenti tabela 3)

- **Tarifa bazë (Tabela 1): 18.5 (që paraqet 18500)**
- **Koeficenti i korigjimit (Tabela 2): -10% (-0.10) + 10% (+0.10) = 0**
- **Koeficenti i korigjimit (Tabela 3): -7% (-0.07)**

(1a) + (1b) + (1c) = 18.500 + 0 – 1.295 = 17.205 (ose **17,205 lekë** për banesën para indeksimit)

18500lek/ apartament 2+1 me kuzhine më vete ndërtesë e vitit 1988 (38 vite)
(Referuar tabelës nr. 1 të VKM 179/2020 për Kategorinë II dhe ndërtimit 1981-1990 me koeficent llogaritje na /000 lek 18.5 ku sipas llogaritjes se formules se VKM-se 320/2026 eshte **Ta= 17,205lekë**).

2.Koeficenti i Korigjimit të vlerës (kk1) :

(+/-10% ose 0, sipas tabelës nr.2 të VKM 179/2020 brenda normave te strehimit sipas Autorizimit dhe VKB te dates.01.03.1999)

3. Koeficienti i Katit (Kk2):

(- 7% ose 0.07, pasi banesa ndodhet në katin përdhe, sipas tabelës nr.3 të VKM 179/2020).

4.Tarifa e Privatizimit te apartamentit (Ta) sipas vkm.179/2020 dhe 320/2026

Ta= 17,205lekë

5.Tarifa e privatizimit të truallit (Tt) vkm.179/2020 dhe 320/2026

Tt = (2a x 2ç) lekë

- 2a) Vlera e truallit: Çmimi referues sipas pikes 22 te vkm per Pogradecin **1080lekë/m²**
- 2b) Koeficenti i llogaritjes se truallit ne bashkepronesi: (Sip e Ap / Sip baneses) (sip e Ap. 476m² sipas ASHK / sip e baneses 71m² sipas çertifikates se prones, 20 banesa)
- 2c) Siperfaqe totale e truallit funksional te objektit m² 476m² ASHK
- 2ç) Siperfaqe qe i takon baneses m² (2a x 2ç) = **23.8m²** (476/ 20 = 23.8)
- 2d) Tarifa e privatizimit te truallit Tt = 1,080 lek/m² x 23.8m² = **25,704 lekë**

6. Koeficienti i Korrigjimit të Çmimit (Indeksimi - I): është 5.619
I nxjerrë direkt nga raporti i Indeksit të Çmimeve të Konsumit të INSTAT (Dhjetor 1992 = 76.4 dhe Dhjetor 2025 = 429.3): **I = 429.3 / 76.4 = 5.619**

(Ta+Tt) x I = 17,205lekë + 25,704lekë x 5.619 = 241,105.671 lekë

7. Vlera 4% e shpenzimeve operacionale 0 lekë
(Dokumentacioni, vertetimet, planvendosja, certifikata, autorizimi etj jane vene në dispozicion nga vetë pala e interesuar për privatizim)

8. Vlera shtesë për sipërfaqe tepër është 0 lekë

9. Ekuacioni i Përllogaritjes së Vlerës totale te baneses : 241,105.671 lekë

Vlera Finale me Zbritje 20% për pagesë të menjëhershme (1 këst) = 241,105.671 lekë - 20% = 192,884.5368 lekë

Për efekt të prerjes së faturës dhe likuidimit, shuma e rrumbullakosur zyrtarisht është:

192,885 lekë

me shifra: (njëqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë lekë)

VI. PASQYRA PËRMBLEDHËSE FINANCIARE (PËR KUPONIN E PAGESËS)

PËRSHKRIMI I ELEMENTIT	VLERA / KOEFIÇENTI	BURIMI LIGJOR / TEKNIK
Sipërfaqja e privatizueshme	71 m² (truall 0 m²)	Certifikata ASHK / Nr. Pasurie 9/95+1-7
Tarifa Bazë (Kategoria II)	18.5% koef. në /000Lekë/m²	Tabela 1, VKM Nr. 179/2020
Koeficienti i Katit (Përdhe)	0.07 (zbritje -7%)	Tabela 3, VKM Nr. 179/2020
Vlera Bazë	17,205 Lekë	(1a x 1c)
Tarifa e Truallit	25,704 lekë	Sipas pikes 22 te vkm
Koeficienti i Indeksimit (INSTAT)	5.619	IÇK 2025 (429.3) / 1992 (76.4)
Vlera e Plotë e Indeksuar	241,105.671 Lekë	4,907.52 Lekë × 5.619
Zbritja Ligjore (Pagesa 1 këst)	20% (zbritje 48,221.13 Lekë)	Pika 25, VKM Nr. 179/2020
VLERA PËRFUNDIMTARE PËR PAGESË	**192,885 Lekë**	**Njëqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë lekë**

VII. PROPOZIMI DHE REKOMANDIMI, KONKLUZIONI

Në përfundim, rezulton se familja përfituese plotëson kushtet ligjore për privatizimin e banesës shtetërore dhe për këtë, pasi u konfirmua përputhshmëria absolute ligjore, kushtetuese dhe teknike e kësaj dosje, Sektori i Strehimit i propozon Këshillit Bashkiak Pogradec:

Miratimin e privatizimit të banesës me sipërfaqe 71 m², e llojit apartament 2+1, me nr. pasurie 9/95+1-7, ZK 8582, e ndodhur në Lagjen 4, Rr. "Kala", Pogradec, në favor të subjektit përfitues

Familja e z.Muhamet Ferit Golemi

(sipas gjëndjes të çertifikatës familjare dt.01.12.1992 – Ligji privatizimit Nr.7652/1992)

Relacionit i bashkëlidhen dokumentacioni si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e kryefamiljarit drejtuar Bashkisë.
2. Kopje e Autorizimit origjinal të lëshuar në vitin 1999.
3. VKB – Nr.12 dt.01.03.1999.
4. Formularet 1,2,3
5. Urdhër nr.1706/1 dt.08.06.1999.
6. Fatura dhe Mandat Pagesa per privatizim.
7. Kopje e Faturës së Energjisë Elektrike dhe Ujit.
8. ID, Çertifikatë personale dhe Çertifikata Familjare.
9. Akt-Verifikimi i Bashkisë (fotot e baneses).
10. Deklarate nga Kryefamiljari.
11. Deklaratë noteriale nga familjarët.
12. Çertifikata e Pronësisë së Apartamentit në emër të Bashkisë Pogradec
13. Plan-Vendosja e apartamentit.
14. Vërtetim nga ASHK (Kadastra).
15. Vërtetime dhe dokumenta te tjera.

Sa më sipër, duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ftojmë këshilltarët që ta votojnë!

Konceptoi: D.DRAGOJ
Pranoi: E.DULELLARI
Miratoi : N.TORRA
Konfirmoi: P.ZIKO

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (0)3) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE

SEKTORI I STREHIMIT, SHPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

Formulari nr.1

TREGUESIT TEKNIKO-EKONOMIKE

1. Adresa: Pogradec - L.4. "Kolaja 9/35 - SHT.
2. Viti i ndërtimit 1988
   a) Shtesë kati Jo
   b) Shtesë anësore Jo
3. Kategoria e ndërtesës I — II Po III —
4. Numri i kateve 5
5. Numri i apartamenteve ..... a) me aneks ✓ b) ~~pa aneks~~

a) 1+1 me —

pa

a) 2+1 me Po ✓

~~pa~~

a) 3+1 me —

pa

c) Garsionere —

PËR BASHKINË
Orjon Dulellari

QYTETARI
Muhamet Golemi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË
ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE
SEKTORI I STREHIMIT, SHPRONËSIMEVE DHE BASHKËPRONËSISË

Formulari nr.2

TREGUESIT KRYESORË PËR APARTAMENTET

1. Adresa: Pogradec. L.4. "Kolonja" 9/95 - BHT
2. Qiramarrësi Muhamet Ferit Goleemi
a) Shtesë kati —
3. Përbërja e apartamenteve sipas numrit të dhomave 2+1
me aneks ✓ pa aneks — shtesë kati — shtesë anësore —
4. Numri i kateve të banesës Pallat Kompleks prej Kat.
5. Vendosja e apartamenteve
6. Kaegoria e banesës I ~ II Po III ~
7. Numri i fryméve sipas çertifikatës së lëshuar nga zyrat e gjëndjes civile, sipas gjëndjes 01.12.1992 3
8. Numri i familjeve që banojnë në apartament 1
9. Tarifa e pagesës
10. Llogaritjet për efektet e parashikuar në ligj në plus ose minus
a) Sip. e Truallit
b) Tarifa Baze
c) Koef. i Kushtëzimit të banesës
d) Koef. i indeksimit IÇK (INSTAT)
e) Vlera baze + Tvulla e Vlera e Plotë
f) - Zbritje për pagesë 1 këst -20%
11. Vlefta që do të paguhet nga qiramarrësi 192.885 lek (njëqind e nentedhjetë e dymijë e tetëqind e tetëdhjetë.

PËR BASHKINË
Arjon Dulellari

QYTETARI
Muhamet Goleemi

Bulevardi "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Lagja: Nr.2. Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Formular nr.3

KONTRATË PËR KALIMIN E PRONËSISË SË BANESËS SHTETËRORE NËPËRMJET PRIVATIZIMIT

Kjo kontratë lidhet sot, më dt..... në Pogradec, sipas VKB nr..... dt.....,

ndërmjet **Bashkisë Pogradec** dhe Familjes (gjendja familjare dt;01.12.1992) së

Z./Zj. Muhamet Fetit Goleemi, lindur më 03.11.1963, me

nr.personal G31103055M, banues në Pogradec - L.4, , banesës me

nr. 9/35 Rruga "Unaze" ZK 8582 kati 0 përdhe ✓ tipologji 2+1 Pallati SHT

"Kolo" sh. 2 kati 0 e përbërë nga 2 dhoma dhe 1 kuzhinë me/pa aneks; Apartamenti është ndërtuar

në vitin 1988 (sipas vertetimit), lidhet kjo kontratë me kushtet e mëposhtme:

Në zbatim të ligjit nr.7652 datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe VKM-ve perkatese nr.179 dhe nr.97 per rregullat dhe procedurën per privatizim te banesave shteterore qe kane mbetur pa privatizuar, qytetari duhet të paguajë vlerën në lek sipas shumës të cituar në **Formularin nr 2** prej

192,885 (njëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

a) Pagesa u shlye në mënyrë të rregullt dhe si rjedhojë duke përfituar me zbritje 20% me mandat arkëtimi nr. 508 datë 11.08.2026 ✓

b) Nëse pagesa shlyhet 50% e vlerës së banesës, përfiton me zbritje 10%

c) Nëse pagesa shlyhet 25% e vlerës së banesës, përfiton me zbritje 5%

d) Nëse pagesa do të shlyhet me kësto, kësti do të jetë mujor sipas përpjestimit të diferences së mbetur deri në shlyerjen totale të saj pagesë e cila do të kryhet pranë drejtorisë së taksave bashki.

e) Nëse pagesa nuk shlyhet dhe pagesa nuk bëhet për 6 muaj radhazi, banesa kalon në pronësi të bashkisë dhe qytetari kthehet në qiramarrës.

f) Nuk ka të drejtë ta shesë apo tjetërsojë banesën pa u pajisur me Çertifikatë pronësie nga ASHK.

g) Qytetari (familja 01.12.1992) fiton pronësinë mbi apartamentin , në momentin e miratimit me VKB, Lidhjen e kontratës së privatizimit, Pagesës së faturës së privatizimit dhe pajisjes me Çertifikatë.

h) Në kushtet e bashkëjetesës në një godinë me shumë pronarë apartamentesh, qytetari detyrohet të respektojë e të përmbushë të gjitha detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore

PËRGJEGJËS I SEKTORIT
Erjon Dulellari

QYTETARI
Muhamet Goleemi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E TAKSAVE DHE E TARIFAVE VENDORE

Nr.1773/1 prot. Pogradec, më 11.08.2026

Lënda: Kthim përgjigje
Drejtuar: **Z. MUHAMET GOLEMI**
Adresa: Rr:"Kala " lagjia nr.4 Kala ,Kodi postar 7301,Pogradec.
Tel:

Në përgjigje të kërkesës suaj, protokolluar pranë Bashkisë Pogradec me nr.1773/1 prot., datë 11.08.2026, në lidhje detyrimet finaciare vendore që rrjedh nga privatizimi i banesës , Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ju bën me dije se tatimpaguesi dhe për **pasurinë** e llojit :

***Sipërfaqe të përftuar nga të cilat 71m²;**

-Nr.Pas 9/95+1-7 , Zona Kadastrale 8582 ,

(me truall 23.8m ² bashkëpronësi me kuotë pjesmarrje) dhe pagesë të menjëhershme me 1(një) këst me zbritje(-20%) me shumën:192,885 lekë (Njëqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind e pesë lekë).

Adresa e Pasurisë ; Lagjia Nr.4 Kala ,Pogradec.

Për pasurinë e lartpërmendur ,ky tatimpagues **nuk rezulton të ketë detyrime** të prapambetura .

E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesë të vetë të interesuarit ,për efekt regjistrimi pranë Agjensisë Shtetërore e Kadastrës ,ASHK Pogradec .

DREJTOR TAKSA &TARIFA VENDORE

ANXHELA PIJUNCI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSISË
ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE SUPERVIZIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. 1773 prot

Pogradec, më 4.4.2026

Lënda: Kërkesë për pagesë detyrimi

Drejtuar:
DREJTORISË SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
KËTU

Në kuadër të bashkëpunimit insitucional, zbatim të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligji Nr.7652, dt.23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", VKM-së nr.179, dt.26.02.2020 sipas VKM-së nr.320 dt.06.05.2026, kërkojmë, sipas kërkesës nr.1773.prot dt.20.04.2026 së z.Muhamet Golemi drejtuar bashkisë për shlyerjen e pagesës së privatizimit të shtëpisë së tij sipas autorizimit nr.12 dt.01.03.1999 miratuar me VKB Nr.12 dt.01.03.1999 sipas gjëndjes familjare të dt.01.12.1992, (tarifë e cila ka mbetur pa paguar).
Po ju përcjellim për pagesë detyrimi nga familja e interesuar për llogari të Bashkisë Pogradec, bashkëlidhur dokumentacionin dhe tabelën e përllogaritjes së tarifës e cila është përllogaritur konform Autorizimit dhe VKB-së nr.12 viti.1999, sipas Ligjit nr.7652 dt.23.12.1992, tabelave 1,2,3 të përllogaritjes së VKM-së 179/2020 dhe VKM-së nr.320/2026, indeksimit të INSTAT, Çertifikatës së pronësisë nr.9/95+1-7 në emër të Bashkisë Pogradec, ndërtesë 71m^2 (me truall 23.8m^2 bashkëpronësi me kuote pjesmarrje) dhe pagesës së menjëherëshme me 1 këst me zbritje -20% e cila do të përdoret për regjistrimin e pronësisë në ASHK në favor të familjes sipas çertifikatës familjare dt.01.12.1992.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Konceptoi: D.DRAGOJ

Pranoi: E.DULELLARI

DREJTORI
NEXHMI TORRA

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail:bashkiapogradec@gmail.com

PASQYRA PËRMBLEDHËSE FINANCIARE (PËR KUPONIN E PAGESËS)

PËRSHKRIMI I ELEMENTIT	VLERA / KOEFIÇENTI	BURIMI LIGJOR / TEKNIK
Sipërfaqja e privatizueshme	71 m² (truall 0 m²)	Certifikata ASHK / Nr. Pasurie 9/95+1-7
Tarifa Bazë (Kategoria II)	18.5% koef. në /000Lekë/m²	Tabela 1, VKM Nr. 179/2020
Koeficienti i Katit (Përdhe)	0.07 (zbritje -7%)	Tabela 3, VKM Nr. 179/2020
Vlera Bazë	17,205 Lekë	(1a x 1c)
Tarifa e Truallit	25,704 lekë	Sipas pikes 22 te vkm
Koeficienti i Indeksimit (INSTAT)	5.619	IÇK 2025 (429.3) / 1992 (76.4)
Vlera e Plotë e Indeksuar	241,105.671 Lekë	4,907.52 Lekë × 5.619
Zbritja Ligjore (Pagesa 1 kësť)	20% (zbritje 48,221.13 Lekë)	Pika 25, VKM Nr. 179/2020
VLERA PËRFUNDIMTARE PËR PAGESË	**192,885 Lekë**	**Njëqind e nëntëdhjetë e dymijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë lekë**

Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Bashkia Pogradec
Nr. 1773 Prot
Date 04 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Pogradec me 20.04.2026

KERKESE

I lëmbështetjetënenit11, pika4 ,nenit 13, 14, 15, tëligjit nr. 119/2014 " Për të drejtën e informimit" ,I ndryshuar, nenit 28, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Përmbrojtjen e të dhënave personale, indryshuar, unëi/e nënshkruari/a **Z/Muhamet Golemi Kerkoj ndermjetesimin e Bashkise per privatezimin e shtepise time te lagjes 4 "KALAJA" per ne ASHK**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentat e nevojshme.

Emër dhe mbiemër I kërkuesit;

MUHAMET GOLEMI

Adresa postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;

Pogradec

Nr. Tel.0694119573

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia Pogradec
Njësia administrative Pogradec 263
Zyra e Gjendjes Civile 263

Datë: 17.06.2026

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të regjistrit themelor të viti 1974, Regjistri 53/90 Pogradec me referencë vërtetohen të dhënat e mëposhtme

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Muhamet GOLEMI	Ferit	Fidane	M	Kryefamiljar	03-11-1963	I/e martuar	Kotoodesh Librazhd	Shqiptare	----------
2.	Shefqedije GOLEMI	Shaqir	Nezire	F	Bashkëshorte	03-07-1960	I/e martuar	Kotodesh Librazhd	Shqiptare	----------
3.	Gladiola GOLEMI	Muhamet	Shefqedije	F	E Bija	08-12-1987	Beqar/e	Librazhd	Shqiptare	----------
4.	----------									----------
5.	----------									----------
6.	----------									----------
7.	----------									----------
8.	----------									----------
9.	----------									----------
10.	----------									----------

Kjo certifikatë lëshohet për Gjendja familjare 01.12.1992

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Jorida Cane

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

Faqe 1 nga 1

Vërtetuar elektronikisht nga Ministria e Punëve të Brendshme
Data:2026.06.17 14:32:09 +02'00'
050d0f4acb5f4f2b1e0f8a5f0f3b0c2020617143297 7
890001

Shtëpia Kombëtare e Arkivave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA POGRADEC	K44802605R	1/1

Numri i Pasurisë	9/95+1-7		
Kodi Unik	8582011177		
Zona Kadastrale	8582		
Lloji i Pasurisë	APARTAMENT		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 71	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	POGRADEC, POGRADEC, Rr.: 4 KALA, Nd.: SMT, Nr. ap.: 7		

DREJTORI
Fabio Latifllari

Denis Muci

Malik Alemllari

Latifllari

2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Pogradec
Data: 2026.01.15 10:48:28 +0200

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE POGRADEC

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 8582

KODI UNIK: 8582 0111

NUMRI PASURISË : 9/95+1-7

IND. HARTËS: PG, C-2

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



DREJTOR

SHPJEGUES

PARCELA

NDËRTESA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 85820[illegible]177
(Nga ____, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8582 , Lloji i Pasurisë: APARTAMENT , Nr. i Pasurisë: 9/95+1-7 , Sipërfaqja Totale 71 m2, (Nga të Cilat Truali 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale PG-C-2 , Numri i Pasnëve: 0 ,
Adresa e Pasurisë: Bashkia POGRADEC , Rruga 4 KALA , Ndërtesa Nr. SMT , SH/K 1 , Apartamenti Nr. 7
Vlera e Pasurisë:
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 153 , Dt. 03/04/1993), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: BASHKIA POGRADEC , Nr. Identifikim/NIPT K44802605R, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia , , Rruga DESHMORET E POJSKES , Ndërtesa Nr. ___ , SH/K ___ , Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit ehtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 153 , Datë: 03/04/1993
Regjistruar: Nr. 018460 , Datë: 16/07/2026

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Determinuar për Pasurinë Nr. ____ , me Kod Unik ____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: ____, Nr. __, Datë: ____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: ____
Regjistruar: Nr. __, Datë: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Aktet Verifikuese	Përfituesi	
			Emërtimi	Nr.	Data		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimit/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Akti i Kufizimit	Përfituesi/Barra	
			Emërtimi	Nr.	Data		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimit/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: ____ , Emërtimi i Aktit: ____ , Nr. __ , Datë: ____
Regjistruar: Nr. __ , Datë: ____
Përshkrimi: .

DREJTORI
Fabio Latifllari

Denis Muci — Digitally signed by: Denis Muci — Date: 2026.07.16 +02:00
Maik Ademllari — Digitally signed by: Maik Ademllari — Date: 2026.07.16 +02:00
Fabio Latifllari — Digitally signed by: Fabio Latifllari — Date: 2026.07.16 +02:00

16/07/2026

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore Pogradec
Data: 2026.07.16 10:48:11 +02:00

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA

Tiranë, më 28.03.1995

VËRTETIM

PËR NXËNËSIT PËR VITIN SHKOLLOR

Me urdhër Nr. 43 datë 01.09.1991 të Ministrisë së Mbrojtjes Gjithë-kombëtare të regjistruar në Regjimentin e Artilerisë me Raketa (Njësia) ushtar SMT (Grada) Qi Ha Dina (Emri) lindur më 2 (Data) (Muaji) 1(Viti)

Komandanti i Regjimentit

Kapiten

Qi Ha Dina

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES GJITHË-KOMBËTARE SEKRETARIATI I PËRGJITHSHËM

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Drejtoria e Programimit Ekonomik dhe Buxhetit

Nr. 1706/1 Prot. Tirane,me 8.6.1999

Nr. 13PP
dt. 9.6.99
Komisioni Shteti...

DEGA E.K.B.
POGRADEC

BASHKIA QYTETIT
POGRADEC

Per njoftim: ENTI KOMBETAR I BANESAVE
TIRANE

URDHER
Nr.1706/1.date 8 .06.1999

Ne zbatim te Urdherit Nr.1 dt.13.01.1999, te Kryeministrit

URDHEROJ

1.Te behen transferim kapital, konform VKM Nr.153 dt. 3.04.1993, nga Dega EKB Pogradec ne favor te Bashkise Pogradec , objektet "Dyqan nen banesen e SMT" dhe "Dyqan nen banesen e Kromit".

2.Keto objekte te shndrohen ne objekte banimi per te pasurehet.

3.Bashkia Pogradec te marre ne dorezim nga Dega EKB Pogradec objektet e mesiperme konform dispozitave ligjore ne fuqi.

Ingrid SHULI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I BASHKISE

V E N D I M

Nr. ___ date ___ 1998

MBI DHENIE AUTORIZIM STREHIMI

PER PRIVATIZIM BANESE

Keshilli i Bashkise i mbledhur ne datën e sotme mbasi mori ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga zoterinjte Muhamet Golemi dhe Fatos Dragoi per paisjen me autorizim per privatizim banese tek Pallatet e Kalase ne mbeshtetje te V.K.M. Nr. 46 date 29.06.1993 "Per trajtimin e banesave ne proces nga viti 1992" Pika 2 dhe 6

V E N D O S I:

- Te paisen me autorizim per privatizim banese personat e meposhtem tek Pallatet e Kalase.
- Muhamet Golemi , Ap. Dy dhoma e nje kuzhine.
- Fatos Dragoi, Ap. Nje dhome e nje kuzhine.

KRYETARI
(Fatos Koleci)

SEKRETARI
Sazan Selmani

JURISTI
Besnik Jasellí

Paraqiti materjalin
Sektori Sherbime, Urbanistik

Shenim:
Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Seksioni Sherbime Urbanistikes prane Bashkise.

BASHKIA POGRADEC 26/1 10.03.2014

Nuj Pleqe!

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

07/03/2014 Nr. 382/1 Prot

DREJTORISË RAJONALE TË EKB-së

Korçë

Lënda: Kthim përgjigje.

Në shkresën tuaj nr. 26/1, datë 03.02.2014, ju përcillni pranë nesh problemin e ngritur nga Bashkia Pogradec lidhur me objektet "Dyqan nën banesën SMT" dhe "Dyqan nën banesën e Kromit", në qytetin e Pogradecit, të cilat me VKM nr.153, datë 03.04.1993, dhe me urdhër të M.P.P.T (sot MZHUT) kanë kaluar në kapital të Bashkise Pogradec.

Për sa më sipër nga ana juaj, në bashkepunim edhe me Bashkine Pogradec, te merren masa për zbatimin e VKM nr. 153, datë 03.04.1993 dhe Urdhërit të MPPT nr. 1706/1, datë 08.06.1999, për realizimin e procedurave të nevojshme për kalimin e pronësisë së objekteve të përmendura në këtë VKM nga Drejtoria Rajonale e EKB-së Korçë në pronësi te Bashkies Pogradec.

Me respekt,
Doris Andoni
Drejtor i Përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE
DREJTORIA RAJONALE KORCE

Adresa: Rr. "Edit Durham", e-mail: entikombetarkorce@gmail.comKorce
Tel: 082242828, Fax: 082242828

Nr. 26/3 Prot.

Korce, me 18.03. 2014

Lenda : *Kerkese per kalim pronesie*

Drejtuar: Bashkise
Pogradec
Per dijeni : Zyres se Rregjistrimit te Pasurise
Pogradec

Bashkelidhur ju dergojme pergjigjen e Drejtorise se Pergjitheshme te Entit Kombetar te Banesave TIRANE me nr 382/1 prot date 07.03.2014 ne pergjigje te shkreses tone ku percollem problemin Tuaj te bere prezent me shkresen nr 99 prot date 28.01.2014 me subjekt *Dergohet informacion,Bashkia Pogradec ku vini ne* dijeni per asetet e percaktuara si me poshte:

- Pallati i Kromit me 24 apartament tip share me dyqane ne tre shkaliet. Rregjistruar ne regjistrin Nr.7 te apartamenteve te banimit me Nr. 2417 transkiptimi.
- Pallati I S.M.T. me 14 apartamente tip share me dyqane. Rregjistruar ne regjistrin Nr.7 te apartamenteve te banimit me Nr. 115 transkiptimi.

Te cilat jane kaluar me VKM 153 date 03.04. 1993 nga EKB Pogradec ne Favor te Bashkise Pogradec me urdher te MInistrit nr 1706/1 date 08.06.1999.
Mbeshtetur ne VKM 153 date 03.04. 1993 nga EKB Pogradec ne Favor te Bashkise Pogradec me urdher te MInistrit nr 1706/1 date 08.06.1999dhe shkresen e Drejtorise se Pergjitheshme te Entit Kombetar Tirane te merren masa nga institucioni I Bashkise Pogradec ne bashkepunim me Zyren vendore te regjistrimit te Pasurise Pogradec te bejne kalimin e pronesise nga Drejtoria rajonale EKB Korce ne pronesi te Bashkise Pogradec. Bashkelidhur shkresa nr 382/1 prot date 07.03.2014.

Shpresojme ne mirkuptimin tuaj.

Laureta ALIDINAJ
DREJTOR I DREJTORISE
RAJONALE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Adresa: Bulevardi "Rruga Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222401, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Nr.2857 Prot. Pogradec më 22/11/2016

LËNDA: Kërkesë për regjistrim

DREJTUAR: Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
POGRADEC

PËR DIJENI: Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,
TIRANË

Në vijim të korrespondencës sonë dhe në kuadër të bashkëpunimit institucional ju kërkojmë regjistrimin e :

1. Gjashtë ambjente në katin e parë tek pallati i kromit e tipit sharrë, regjistruar në regjistrin nr.7 të apartamenteve të banimit nr.2417 transkiptimi
2. Dy ambjente tek pallati i SMT-së i tipit sharrë regjistruar në regjistrin nr.7 të apartamenteve të banimit nr.115 transkiptimi.

Bashkangjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Urdhër nr.1706/1, datë 08.06.1999 të Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit
- Kërkesë për kalim pronësie nr.26/3prot., datë 18.03.2014 e Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Korçë
- Kthim përgjigje nr.382/1prot., datë 07.03.2014 e Entit Kombëtar të Banesave
- Listën e objekteve për privatizim nga Entit Kombëtar i Banesave
- Planvendosje e 6 ambjenteve në katin e parë tek pallati i kromit
- Planvendosje e 2 ambjente tek pallati i SMT-së

Përsa më sipër kjo kërkesë i është dërguar më parë ZVRPP Pogradec me shkresën nr.99/9 prot., datë 25.09.2014, por nuk kemi marrë përgjigje.

Falemnderit për mirëkuptimin !

Konceptoi :
Ivana LLAKMANI

Jurist :
Erjon PALLA

Drejtori :
Lindita BICE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
Eduart KASRI
KRYETAR

ËRKESË	Nr i kërkesës	Data e aplikimit	Data e përfundimit	Rrethi	Zona
	1,869	19/04/2019	30/04/2019	POGRADEC	Zona2

Informacion mbi pasurinë e përfshirë në aplikim

POGRADEC
POGRADEC
POGRADEC2

K	Indeksi i h	Numri i pas	Vol	Faqe
8582		999/999	999	999
11 - 6 mjesi		9/64	10	129
11 - 2 mjesi		9/95	11	170

3. Shërbimet dhe pagesat

Kodi	Emri	Njësi	Sasia	Takse	Kopja	Kamata
M	Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale	8	1000		2	0.00
I5	Lëshim kopje kartela te pasurisë	8	1000		5	0.00
L1	Lëshim certifikate pronësie	8	1500		5	0.00
R2	Regjistrimi i kalimit te pronësisë me ane te ligjit, me vendim te gjykatës, apo te një akti administrativ	8	3500		7	0.00
		Totali	56000	0		0

Kërkuesi

Fillareta Margarit Buzo
2983262
Leternjoftim
G75314091M
POGRADEC

4. Dokumentat

Kodi	Emërtimi	Faqe	Burimi	Numri	Data	Kopje
A27	Shkresë perçjellëse nga institucioni që ka kryer akt/n	7	Kerkuesi	3857/Pro	25/3/2019	1
D1	Dokument identifikimi	1	Kerkuesi		19/4/2019	1

Përfaqësuar nga:

Fillareta Margarit Buzo
2983262
Leternjoftim
G75314091M
POGRADEC

5. Pranimi i kërkesës:

Verifikoj se dokumentat e paraqitur nga kërkuesi janë të mjaftueshme për fillimin e procesit të dhënë e evidentuar në Zyrën e Rregjistrimit.

Andi Niko Divjaka
19/04/2019 11:15:03

falje e gjobave

Për ndjekjen e aplikimit në web: www.zrpp.gov.al
WT9PPG
IDhKwa

7.Verifikimi i pagesës dhe aplikimit

Pagesa totale për aplikimin:
56,000.00

FATURË PËR ARKËTIM

Nr : 1741 Datë 2019-04-19

e anë të kësaj fature kërkojmë që Banka juaj të pranojë nga klientë (persona / persona fizik / persona juridik) arkëtime, për llogari të stitucionit tonë, me emërtime, kode, numër identifikimi dhe shuma si më poshtë:

stitucioni përfitues:

mri	Z.V.R.P.P. POGRADEC
odi	1014086
r. llogarisë	321942120000012
BAN	AL659014218300321942120000017

Nr Të ardhura nga:	Kodi i llogarisë	Shuma në (Lekë)
1 Shërbimet	7112300	56,000.00
2 Gjoba	7115416	
3 Taksa e kalimit te pronësisë (3%)		0.00

Totali i Faturës për Arkëtim 56,000.00

Andi Niko Divjaka

Fillareta Margarit Buzo

Pagesa të tjera

Të ardhurat	Përfituesi	IBAN	Numri Llogarisë	Shuma në (Lekë)
				0.00

Taksa mbi kalimin e pronesie (15%) Sektori i taksimeve te tjera

Kodi institucionit per RVP 1010162

Kodi i thesarit per RVP 1529

Pagesa totale për aplikimin 56,000.00

Pagesat kromsi + SH.T

Institucioni	BASHKIA POGRADEC
NIPT - i	K44802605R
Kod Institucioni	2136001
Njesite i Qeverisjes	136
Distrikti (TDO)	1529

Nr. i Kuponit F3866

URDHER - SHPENZIMI

208 DATE 23.04.2019

Nr.i Punonjseve

Nr.	Struktura e Ilogarive						SHUMA	
	Ca.	Kap.	Kod Program	Llogaria Ekonomike	Nen Llogaria	Kod Projekti	ne Leke	Objekti i shpenzimit
1								Pagese per sherbimin te kerkuar ndaj
2	00	01	01110	6021099		9999999	56,000.00	Z.V.R.P.P Pogradec
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
TOTALI ME SHIFRA							56,000.00	
TOTALI ME FJALE							pesedhjete e gjashtemije leke	

Te dhena per kreditorin perfitues :	
Emri i perfituesit	
Vera e Regjistrimit te Pasurise Pogradec	
NIPT - i	K54104601V
Nr.llog.bank	321942120000012
Emri Bankes	Banka Kombetare e Greqise
Adresa e Bankes	Pogradec

Dokumentat ngjitur Urdher Shpenzimit :		
Emertimi	Nr. Dokumenti	Date Dokumenti
Autorizim	Nr 1935	Dt 24.05.2017
Fature per arketim	Nr 1741	Dt 19.04.2019
Nr kerkese	Nr 1869	Dt 19.04.2019

PER INSTITUCIONIN

Aprovuar date 23.04.2019

URDHERUESI (Eduart Kapo) KONTABILISTI (Kozmano)

PER DEGEN E THESARIT

NEPUNESI I THESARIT (Vula)

Shenim: Ne kolonen "Nr. i kuponit" dhe "Aprovuar date", plotesohen nga nepunesi i Thesarit

Formati i kesij Urdheri Shpenzimi eshte miratuar nga Ministri i Financave me shkresen nr. 6151 date 27.06.2008

INVENTARI

I dokumentacionit te z. MEHMET GOLEMI

	Nr.Flete	Origjinal	Fotokopje
FORMULARI 1	—	1	
FORMULARI 2	—	-	
FORMULARI 3	—	-	
Planimetri	—	1	
Plan Vendosje	—	—	
Çertifikate e 1.12.1992	3 (TRE)	3	
Mandat pagesa	—		
Autorizimi	1 (NJE)	Fotokopje	
Kontrata e shitblerjes	—		
Dëshmi trashëgimie	—		

Dorezuesi

Tanja MATO

Marresi

Ivana LLAKMANI



KUFIZIMET E PASURISE 9/95 Vol 11 faqe 170

VERI-----9/266,9/96
LINDJE----9/96
JUG-----9/171
PERENDIM-9/268,9/248

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA

Pogradec me 10.03.1999

R I F R E S K I M

AUKTORIZIMI PER PRIVATIZIM BANESE

Me vendimin Nr. 12 date 01.03.1999 te ambilit te Bashkise z. Muhamet Gokuni te strehohet me familjen e tij te perbere nga 4 (kater) fryme ne banesen SMT ce ka dhoma 2 (dy) kushtime 1 (nje),

Pergj.Sek.Administrate

Tatjana Jergelli

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA

Pogradec me 19.10.2000

V E R T E T I M

Vertetojme se z. Muhamet Gokuni eshte banor i qytetit te Pogradecit dhe figuren i regjistruar ne listat e te pastrehove prane Bashkise.

E lejohejme kete vertetim me kerkesen e te interesuarit si dhe ne baze te listave e te pastrehove.

Pergj.Sek.Administrate

Tatjana Jergelli

Lista e objekteve per privatizim nga Ministria e [illegible] E.K.D.Korce.

Nr. Prones	Prefektura	Bashkia	Emertimi i njohes vendodhja,shtrirja gjeografike	Perfaqesuesi i Ministrise perkatese			
				Permasat e prones ne m2	Emer Mbiemer	Telefon	email
Objekti 1 Regjistri Nr.71 i apartamentave Nr.2417 Transkiptim	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	5.96*4.88 = 29.08			
	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	5.96*5.28 = 31.47			
	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	6.76*5.38 = 36.06			
	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	7.86*5.38 = 42.28			
	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	7.06*5.38 = 37.98			
	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	5.76*5.38 = 31.34			
Objekti 2 Regjistri Nr.71 apartamentave Nr 115 Transkiptim	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	Sip.=71.36			
	Pograsec	Pograsec	Lagjja Kala, Pogradec	Sip.=71.36			
					Ermal Kita	[illegible]	

Shenim: Ne objektin e pare dy ambientet jane pershtatur per banese dhe 4 te tjerat shfryterohen nga banoret per qellare.
Në objektin e dyte te dy ambientet jane pershtatur per banese.
Sipas pozave bashkelidhur.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIATI BASHKIA POGRADEC

LIGJ
Nr. 22/2018

PËR STREHIMIN SOCIAL
(ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi
(ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023)

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së programeve sociale për strehim, si dhe programit për strehim të të punësuarve të administratës publike, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm e të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Neni 2
Përkufizime
(shtuar pikat 11/1, 15/1, 28/1, 52-58; ndryshuar pikat 16, 25, 44 me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Aftësi paguese" është tërësia e mjeteve financiare që një familje mund të përdorë për pagesën e qirave ose të kësteve të kredive, në raport me të ardhurat familjare, në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. "Administrator shoqëror" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.
3. "Azilkërkues" ka të njëjtin kuptim siç përkufizohet në legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë.
4. "Banesë" është bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur (derë) dhe dalje në rrugën publike.
5. "Banesë sociale" është tërësia e banesave të përfituara sipas programeve sociale të parashikuara nga ky ligj.
6. "Banesë sociale me qira" është banesa që jepet me qira, në pronësi publike, nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë e mbeten në pronësi të subjekteve private, por që vihen në dispozicion të programit të banesave sociale me qira, me pëlqimin e pronarit privat.
7. "Banesë me kosto të ulët" është banesa që ndërtohet në përputhje me të gjitha kushtet teknike, standardet e ndërtimit dhe normat e strehimit në fuqi dhe që vihet në dispozicion të njërit prej

VENDIM
Nr. 179, datë 26.2.2020

PËR RREGULLAT, KUSHTET DHE PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE QË KANË QENË SUBJEKT I LIGJIT NR. 7652, DATË 23.12.1992, "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE", DHE TË LIGJIT NR. 9321, DATË 25.11.2004, "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË BANESA, TË NDËRTUARA ME FONDET E SHOQËRIVE DHE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE"

(Ndryshuar me vendimin nr. 542, datë 29.7.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja "a", e 3, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe procedurave të privatizimit dhe përfituesve, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", për banesat ose objektet e kthyera në banesa të ndërtuara nga shteti, të cilat vijojnë të jenë në pronësi të shtetit e rezultojnë të paprivatizuara dhe të paregjistruara në regjistrin kadastral të pasurive të paluajtshme, kur këto banesa:

a) kanë qenë objekt privatizimi sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", por kanë mbetur pa u privatizuar nga familja që e ka poseduar me kontratë qiraje në ish-ndërmarrjet komunale banesa;

b) janë objekt privatizimi dhe janë banesa të ndërtuara deri më 31.12.1990 dhe që i kanë kaluar në administrim dhe/ose pronësi Entit Kombëtar të Banesave (në vijim, EKB) me akte nënligjore, sipas ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa dhe fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore".

2. Privatizimi i banesave, që kanë qenë objekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe që, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", figurojnë në pronësi të shtetit, kryhet në emër të personit, i cili ka pasur kontratë qiraje me shtetin para vitit 1992 dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, sipas certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.12.1992. Kontrata e qirasë ose, në mungesë të saj, dokumente që vërtetojnë qiradhënien para vitit 1992, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 11, të këtij vendimi, shërbejnë për të vërtetuar personin si përfitues i privatizimit.

3. Privatizimi i banesave dhe i objekteve të kthyera në banesa, që kanë qenë objekt i ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore" dhe që, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", rezultojnë ende të paprivatizuara, bëhet në emër të personit/ave, që ka/në emrin në listën e trashëguar nga ish-ndërmarrjet shtetërore dhe të personave të tjerë madhorë të familjes, që bëjnë pjesë në certifikatën e gjendjes familjare të datës 1.12.2004.

4. Privatizimi i banesave apo i objekteve të kthyera në fond banese, sipas këtij vendimi, bëhet bazuar në cipërfaqet e banimit, të përcaktuara për normat e strehimit që janë në fuqi në momentin e privatizimit. Çdo sipërfaqe e përfituar mbi ato të normave të strehimit do të llogaritet me çmimin e tregut.

5. Privatizimi i banesave dhe i objekteve të kthyera në banesa, të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 77, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", bëhet nga subjekti shtetëror që ka në pronësi objektin ose që i ka kaluar pronësia e objektit me vendim të Këshillit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 320, datë 6.5.2026

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.179, DATË 26.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT, KUSHTET DHE PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE, QË KANË QENË SUBJEKT I LIGJIT NR.7652, DATË 23.12.1992, "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE", DHE TË LIGJIT NR.9321, DATË 25.11.2004, "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË BANESA, TË NDËRTUARA ME FONDET E SHOQËRIVE DHE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE"", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja "a", e 3, të nenit 77, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.179, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, që kanë qenë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore"", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

